

Njoftim për përqendrim me të cilin Junajted Media S.a.r.l. Luksemburg fiton kontroll të vetëm mbi shoqërinë ASKANIUS MEDIA D.O.O., Bosnje dhe Hercegovinë dhe Askanius Media, promovim dhe marketing, d.o.o. Slloveni (lënda nr. 08-34/2022)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë "nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më datë 31.01.2022, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin shoqëria "Junajted Media S.a.r.l. (*United Media S.à.r.l.*), me seli në adresën Pjer Friden 43, 1543 Luksemburg, do të fitoj kontroll të vetëm mbi shoqërinë "ASKANIUS MEDIA d.o.o. (*Ascanius media d.o.o.*), me seli në adresën rr. Mjedenica nr.54 71000 Sarajevë, Bosnje Dhe Hercegovinë dhe "Askanius Media", promovim dhe marketing, d.o.o., (*Ascanius Media, promocija in trženije, d.o.o.*), me seli në adresën Dunjaska cesta 5, 1000 Lubjanë, Slloveni.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktiviteti i tyre i biznesit :

Junajted Media S.a.r.l. është një shoqëri veprimtaria themelore e të cilës është transmetimi i TV-kanaleve. Aktivitetet e biznesit përfshijnë këshillimin, menaxhimin dhe furnizimin e përmbajtjes programore, respektivisht prodhimin dhe transmetimin e kanaleve, të cilat më pas shpërndahen përmes operatorëve të telekomunikacionit tek përdoruesit përfundimtarë.

Junajted Media S.a.r.l. është pjesë e Grupit të kompanive Junajted, e cila operon si pjesë e një portofoli të Fondeve të këshilluara nga "BC Partners LLP(*BC Partners LLP*), një fond ndërkombëtar i investimeve me seli në Londër.

BC Partners janë të pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut nëpërmjet shoqërive(indirekte) të varura:

- Total TV d.o.o. Shkup, me seli në adresën Bulevardin VMRO 3, Qendër, Shkup, e cila është aktive në shpërndarjen e përmbajtjeve të mediave :
- Direkt Media d.o.o.e.l., me seli në adresën "Orce Nikolov "68/3, Qendër, Shkup e cila merret me aktivitetet e marketingut.

ASKANIUS MEDIA D.O.O., dhe Askanius Media, promovim dhe marketing, d.o.o. janë agjenci të mediave që ofrojnë një shërbim të integruar komunikimi duke përfshirë konsultë, reklamimin, planifikimin e medias, kërkimin, mbledhjen dhe interpretimin e informacionit të klientit, shërbime krijuese, etj. Veprimtaria themelore përbëhet nga aktivitetet e marketingut, respektivisht aktivitetet që kanë të bëjnë me reklamimin në media. Shoqëritë e synuara i përkasin grupit Askanius Media që operojnë në Slloveni dhe Bosnje dhe Hercegovinë.

Asnjë nga shoqëritë e potencuar nuk ka shoqëritë lidhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Sa i përket **shtrirjes gjeografike të tregut** për përqendrimin në fjalë, parashtruesi propozon që tregu relevant gjeografik të përkufizohet si territor i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në lidhje me tregun relevant të mallrave për përqendrimin në fjalë, parashtruesi propozon që i njëjti mund të përkufizohet si një treg për shërbimet e komunikimit të marketingut dhe një treg për blerjen e hapësirës së mediave.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstaton se përqendrimi në shqyrtim mund të bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

11.02.2022

Shkup